

VENDIM
Nr.214, datë 25.2.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS KUSHOVË, TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kushovë, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kushovë, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.3, datë 4.1.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kushovë, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kushovë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kushovë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
9-17	Varrezat publike	Në pronësi
18-89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillim ekonomik.	Në pronësi
105-109	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizime	Në pronësi
110-135, 137-169	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
248-264	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
265,266, 267,269, 271,273,275,99-104	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
268, 270, 272, 274	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

